

Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" zhvilloi Konferencën Shkencore "Zgjerimi i BE-së dhe sfidat e përafrimit të legjislacionit në Shqipëri"

Në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", nga Departamenti i së Drejtës, pranë Fakultetit Ekonomik, zhvillohet me sukses Konferenca Shkencore "Zgjerimi i BE-së dhe sfidat e përafrimit të legjislacionit në Shqipëri". Kjo konferencë organizohet në kuadër të programit Jean Monnet, duke bashkuar për tri ditë radhazi ekspertë, akademikë dhe studentë që shfaqën interes të veçantë në fushën e integritimit evropian. Në fjalën e tij përshëndetëse Rektori i Universitetit Prof. Dr. Skender Topi, u ndal në kontributin që ka konferenca në kuadër të Programit Jean Monnet në përafrimin e Universitetit të Elbasanit me universitetet evropiane, si edhe rolin që luan si promotor për të çuar përpara mekanizmat legjislativë që na përafrojnë me Bashkimin Evropian. Rektori theksoi rëndësinë që ka ky projekt për pasurimin e kurrikulës universitare nga Departamenti i së Drejtës, duke ofruar module dhe lëndë në përshtatje me të drejtën evropiane.





